



Miratohet
Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet
Minister i Shëndetësisë
Vangjel TAVO

Rustem Paci
Sekretari
Rustem PACI

UDHEZIM MBI PROCEDURAT E VLERESIMIT TE
APLIKIMIT PER NJOHJE NGA KMR SI FIZIKAN
MJEKESOR

Nr 4629/1 prot datë 01.11.2012

PROCEDURAT E VLERESIMIT TE APLIKIMIT PER NJOHJE NGA KMR SI FIZIKAN MJKESOR

Mbeshtetur ne Ligjin 8025 date 9/11/1995 ,i ndryshuar Neni 9 PIKA 2. "Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet miraçon kodet e praktikave, udhëzimet dhe norma të tjera, të lidhura me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues.", KMR percakton procedurat per njohjen nga ana e KMR-se te fizikanit mjekson .

Aplikimi per njohje nga KMR si fizikan mjekson behet per te gjitha veprimtarite qe i parashikon ligji "Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese " Nr. 8025 date 9/11/1995 ,i ndryshuar. Aplikimi per njohje behet prane prane QFBZ tek personi i ngarkuar per kete qellim(jo ne menyre elektronike ose me poste). Personi perqjegjes pret aplikuesin dhe i sqaron kriteret per vleresim. Pas plotesimit te dokumentacionit, ai dorezohet ne QFBZ duke shenuar daten e dorezimit, nr e fleteve, sipas formatit te percaktuar (bashkengjitur ketij materiali) dhe mbahet ne dy kopje. Nje kopje i jetet aplikuesit si vertetim i dorezimit te dokumentacionit. Personi perqjegjes i QFBZ-se ben nje vleresim te per gjithshem te aplikimit duke pare plotesimin e te gjithe rubrikave dhe pas plotesimit te dosjes, ajo siglohet ne faqen e pare nga ai dhe i paraqitet grupit te punes per vleresimin e aplikimit per njohje fizikan mjekesor nga ana e KMR-se. Ne varesi te dokumentve te dorezuara mblidhet grupi i vleresimit ,i cili ben nje vleresim me shkrim ne lidhje me dokumentat e paraqitura jo me vone se tre muaj nga momenti i aplikimit.Vleresimi realizohet kundrejt kritereve te miratuar nga ana e KMR-se.Grupi i vleresimit perbehet nga perfaqesues dhe ekspertete. Me perqatitjen e vleresimit, ai dergohet me shkrim tek sekretari i KMR-se se bashku me dosjen perkatese. Sekretari i KMR-se perqatit propozimin per njohje nga ana e KMR- se ne mbledhjen e radhes per vleresimin perfundimtar. KMR mban inventarin e dosjeve dhe vlersimeve.

Ne mbledhjen Nr 459 date 31 Jnar 2012 , me ane te dokumentit Nr 459/1 date 31 01 2012 KMR vendosi se do te njohe si fizikan mjekesor ato persona te cilet plotesojne kushtet e me poshtme

1. Percaktimi i Statusit te fizikanit mjekesor ne Shqiperi

Fizikan Mjekesor

Ne Shqiperi percaktimi i statusit te Fizikanit Mjekesor do te plotesonte nje nga kriteret e Vendosjes se Standarteve te Sigurise ndaj Rrezatimit jonizues te Komunitetit European si dhe te IAEA (GSR III), si dhe do te fillonte procesin e unifikimit te ketij profesioni me vendet e tjera Europiane.

Njohja formale e Statusit te Fizikanit Mjekesor duhet te realizohet ne dy faza:

-Faza e pare (I) si faze transitore per fizikanet qe aktualisht jane duke ushtruar kete profesion ne Qendra Spitalore, detyrat dhe perqjegjesite e te cileve jane ekuivalente me ato qe percaktojne standartet Europiane.

-Faza e dyte per Fizikanet Mjekesore te ardhshem qe do te duhet te ndjekin kurikulat qe po perqatiten ne nivel Masteri (sistemi i Bolonjes), dhe trajnimi klinik.

Faza e pare

I.Per fizikanet qe jane ne faze tranzitore te fitimit te ketij titulli duhet plotesuar kushtet e meposhtme, te ndara ne kushte te per gjithshme dhe ne kushte te vecanta per te tre drejtimet e Fizikanit Mjekesor:

Kushte te per gjithshme:

- Te kete nje diplome Universitare ne Fizike.
- Te kete jo me pak se dy vjet eksperience pune ne nje Qender Spitalore ne Radioterapi, Mjekesi Berthamore apo Diagnostike.
- Te kete kryer specializim te pakten 6 muaj ne fushen e Fizikes ne Shqiperi apo jashte saj.
- Te kete ndjekur te pakten nje kurs mbi radiombrojtjen si dhe kete njojuri te bazes ligjore persa i perket mbrojtjes nga rrezatimi
Fizikanet qe kane me shume se 7 vjet pune ne Radioterapi, Mjekesi Berthamore apo radio-diagnostike e fitojne automatikisht statusin e Fizikanit Mjekesor ne fushen perkatese vetem me plotesimin e ketij kushti.

Kushte te vecanta

Ne Radioterapi

- Te kete njojuri mbi Dozimetrine Fizike te aparaturave radioterapeutike ne te leterapi dhe brakiterapi duke perfshire :komisionimin, kalibrimin, dhe kontrollin i sigurise.
- Te kete mare pjese ne komisionimin e te pakten nje aparature megavoltazhi
- Te kete njojuri mbi Sistemin e Planit te Trajtimit (SPT), dhe dozimetrine klinike te pacienteve.

Ne Mjekesi Berthamore

- Te kete njojuri ne testet e pranimit, komisionimin dhe sigurine e cilesise se pajisjeve te mjekesise berthamore
- Te kete njojuri ne matje te aktivitetit te radionuklideve dhe dozimetri klinike.
- Te kete njojuri ne perqatitjen dhe aplikimin e protokolleve te cilesise se pajisjeve te mjekesise berthamore

Ne Radio-Diagnostike

- Te kete njojuri ne testet e pranimit, komisionimin dhe sigurine e cilesise se pajisjeve diagnostike
- Te kete njojuri mbi dozimetrine dhe optimizimin e dozave per pacientet .

Faza e dyte

Per Fizikanet Mjekesore te ardhshem eshte e nevojshme kryerja e studimeve akademike te nivelit Master ne Fizike Mjekesore, si dhe ndjekja e nje programi trajnimi ne klinike.

Pjese e rendesishme e ketij procesi do te ishte vendosja e kriterit te trajnimit ne klinike pas masterit per nje periudhe dy vjecare . Trajnimi duhet te kryhet nen supervizimin e nje Fizikani Mjekesor me eksperience.

Ne parim pas kryerjes se trajnimit, kandidati aplikon prane KMR per marjen e Statusit te Fizikanit Mjekesor.

Statusi i Ekspertit ne Fiziken Mjekesore

Ne lidhje me marjen Statusin e **Ekspertit ne Fizike Mjekesore**, duhet qe Fizikani Mjekesor te kete te pakten 5 vjet pune te vazhduar ne kete fushe. Te kete kryer kurse te rritjes profesionale nepermjet trajnimesh dhe specializimesh te vazhdueshme ne fushen perkatese.

QENDRA E FIZIKES BERTHAMORE TE ZBATUAR

Tiranë tel / +355 4 fax: + : e-mail :

VËRTETIM

Vërtetojmë se Z./Znj.....
ka dorëzuar në QFBZ dosjen për aplikim per

.....
Me nr rendor date.....
Numri i faqeve ne total

Personi perqjejes per pranimin e dokumentacionit ne QFBZ	Personi juridik ose fizik qe dorezoi dokumentat
Emer _____ Mbiemer _____	Emer _____ Mbiemer _____ Nr karte identiteti _____
Firme	Firme

Ky vertetim nuk nekupton faktin qe aplikuesi eshte i njojur nga ana e KMR-se si ekpert dhe nuk e perjashton nga asnje lloj detyrimi tjeter ligjor